

RAPORT KËRKIMOR

FORCA ËSHTË GRUA

Roli kontributiv i grave shqiptare, nisur nga profesioni, në periudhën e tërmetit dhe përgjatë pandemisë COVID-19

Tiranë 2020

Përgatitën raportin:
MSc. Evis Nasto
Ma. Enxhi Nasto



PËRMBAJTJA

Abstrakt.....	3
Parashtrimi i këndvështrimeve për figurën e gruas.....	4
Qëllimi i studimit dhe pyetjet kërkimore.....	6
Metodologjia kërkimore e ndjekur në realizimin e këtij studimi.....	7
Respektimi i konfidencialitetit dhe parimeve etike në kërkimin për gruan.....	8
Karakteristikat demografike të grave pjesëmarrëse në studim.....	8
Figura 1.1.....	11
Figura 1.2.....	12
Figura 1.3.....	13
Prirja e grave drejt profesioneve me karakter sfidues.....	14
Vështirësitë e natyrave të ndryshme në kontekstin e punës përgjatë periudhës së pandemisë COVID-19.....	15
Forca e gruas për rrëzimin e paragjyqimeve në profesionet me karakter maskil.....	17
Ofrimi i kontributeve profesionale të grave në periudhën e post-tërmetit dhe gjatë pandemisë.....	19
Gruaja përballë moshës si faktor biologjik.....	21
Refuzimi i burokracive dhe orientimi drejt zgjidhjeve konkrete.....	22
Vetësakrificimi si karakteristikë përfaqësuese për gruan.....	23
Niveli i lartë i empatisë në profesion si formë përshtatjeje e gruas në mjedisin ku ndodhet.....	25
Realizimi i punës në orare të gjata si mbingarkesë psiko-fizike për gruan.....	27
Shanset e pabarabarta për gruan.....	28
Gruaja sipas perceptimeve të opinionit publik.....	29

Pasqyrimi i mendimeve për partnerët e tyre.....	32
Përfundimet.....	33
Rekomandimet.....	34
Bibliografia.....	35

ABSTRAKT

Realizimi i një studimi të tillë cilësor me pjesëmarrjen 8 personazheve të njohura gra në fusha të rëndësishme të shoqërisë, për t'u prezantuar me kontributet e tyre, ishte një angazhim profesional shumë i vlefshëm për vetë kërkuesit. Ky studim shërben si burim frymëzimi për çdo grua shqiptare, e cila kërkon të ketë një forcë të brëndshme për të bërë ndryshime të mëdha në jetën e saj. Ky studim përmban të gjitha rrëfimet jetësore të çdo gruaje të kampionuar, duke na dhuruar momente, përjetime, si dhe ngjarje të ndryshme në jetën e tyre, sepse forca është grua. Studimi orientohet nga një qëllim shumë specifik, që nxiti kështu gjithë organizimin e aktivitetit kërkimor. Qëllimi i referohet pasqyrimit real të roleve të gruas dhe ofrimi i kontributeve të saj në planin profesional për adresimin e problematikave përgjatë këtyre dy krizave historike si tërmeti i 26 Nëntorit si dhe pandemia globale COVID-19. Hulumtimi mbi jetët e tyre familjare, ndërtimi i karrierës si dhe rrëzimi i paragjykimeve falë forcës së tyre ka qënë epiqendra e gjithë kërkimit.

Fjalët kyçe: Grua, profesioni, kontribute, pandemia, tërmeti.

HYRJE

I. Parashtrimi i këndvështimeve për figurën e gruas.

Thirrjet feministe janë për lirinë njerëzore të gruas; për të promovuar të drejtat e saj të nëpërkëmbura kurdoherë nga sisteme të forta maskiliste, që përpriqen ta pozicionojnë gruan vetëm si qenie riprodhuese jetësh. Historia ka dëshmuar se vajzat dhe gratë janë më shumë se kaq, duke sjellë për rrjedhojë, ndër dekada dhe shekuj, rishikimin e roleve të gruas në shoqëri. Më përpara një grua e denjë nënkuptonte një nënë shembullore, një shtëpiake e zonja, një nuse e respektuar për prindërit e bashkëshortit, prej të cilit ajo ishte e varur ekonomisht. Ndërkohë që sot një grua mbizotëron me intelektin e saj, arritjet profesionale, ndjek pasionet e saj, madje edhe në fusha dikur domein të burrave. Më e vështira ndër to për t'u sfiduar, pushteti politik.

Vendosmëria e grave për të qenë në një nivel edhe më të lartë performance se burrat, edhe në drejtim, i ka sprovuar ato me sfida nga më të ndryshmet, duke i zhvilluar tiparin e vendosmërisë, që shpesh i ka shëndrruar edhe në motiv frymëzimi për vendimmarrjen politike të burrave nën petkun e udhëheqësit sikurse ka ndodhur me presidentin amerikan Xhorxh E. Bush. Ky i fundit i kritikuar për një kohë të gjatë për “dobësinë e karakterit të tij” (një fyerje jo e vogël për një burrë), duket se mori një pikë kthese pikërisht atëherë kur vendosi t'i shpallte luftë regjimit të Sadam Huseinit në Irak. Si nxitje për të shërbeu pikërisht një grua, ish-kryeministrja britanike Margaret Theçer, nga goja e së cilës dolën këto fjalë: “*Mos ec drejt nesh duke u lëkundur sa në një anë në tjetrën Xhorxh*” (Goldstein, 2001).

Lufta është një nocion që gjithmonë i është atashuar natyrës mashkullore. Botëkuptimi feminist gjen më shumë argumente për të mbështetur idenë mbi luftën si qëllim mashkullor. Antropologët kanë zbuluar se në të gjitha kulturat gjuetare-mbledhëse, meshkujt janë kryesorët (e shpesh të vetmit) luftetarë në luftë... roli i grave ndryshon shumë nga një shoqëri në tjetrën. Megjithëse ato rrallë marrin pjesë në luftime, gratë ndonjëherë japin mbështetje logjistike për luftëtarët burra e ndonjëherë ndihmojnë për nxitjen e ekstazës për luftë tek burrat nëpërmjet kërcimit, poshtërimit të burrave që nuk shkojnë në luftë dhe veprimtarive të tjera në mbështetje të përpjekjeve luftarake. Megjithatë në kultura të tjera, gratë i largojnë burrat prej luftës ose luajnë role të veçanta si ndërmjetësuese për t'u dhënë fund luftërave (po aty, fq.135-136).

Ideja se gratë janë paqebërëse ka një histori të gjatë. Sipas Henderson (1987, cit. nga Goldstein, 2001) në Athinën e Lashtë, dramaturgu Aristofani hamëndësonte se si mund t'i jepnin fund gratë luftës jopopullore të Peloponezit me Spartën, e cila po zgjerohej gjithnjë e më shumë. Në dramën me të njejtin emër të personazhit kryesor, një grua e re me emrin Lisistrata organizon gratë athinase e spartane që të mos bëjnë seks me burrat derisa këta të ndalin luftën. Në fund të fundit, burrat vijnë në vete dhe bëjnë paqe. Duke iu referuar historisë, Goldstein (2001) i bashkohet logjikës feministe në përpjekje për të krijuar një praktikë feministe të marrëdhënieve ndërkombetare, e cila do të ofronte një alternativë të ndryshme nga praktika mashkullore e realizmit. Fjalët motivuese të UN Educational Scientific and Cultural Organization (UNESCO) janë: *“Përderisa lufta vërtetë fillon në mendjet e burrave, edhe themelet e paqes duhet të kërkohen në mendjet e burrave”*. **Për feministët lufta vërtetë fillon në mendjet e burrave, por themelet e paqes do të duhej që më mirë të kërkoheshin në mendjet e grave.**

Studimet mbi gratë janë zhvilluar me qëllime kërkimore për të ndryshuar pikërisht perspektivat seksiste ndaj grave sikurse përkufizimi i tyre si një grup i paaftë për disa aktivitete të caktuara mendore dhe fizike, apo qoftë ekzistenca e një mendësie se gratë janë qenie që i përshtaten fenomenit të dhunës. Puna për të korrigjuar këtë fenomen që buron kryesisht nga disinformimi nuk është një detyrë e lehtë, pasi koncepti i te qenurit grua dhe nëntekstet që mbart ky koncept janë shpikur dhe kontrolluar nga burrat. Është kryer shumë punë në fusha të ndryshme si biologjia, sociologjia, antropologjia dhe historia për të zbuluar të vërtetën rreth jetës së grave (Miller, 1985). Mungesa e modeleve pozitive, bën që gratë të mos demostrojnë rebelizmin apo pavarësinë e tyre. Dikur grate nuk kishin histori, por historia u është treguar atyre dhe ato e kanë besuar (Ajdini, 2011).

Në këtë optikë vjen dhe ky studim i mbështetur në intervistimin e disa prej personaliteteve të njohura të grave shqiptare që vijnë nga fusha të ndryshme profesionale, të cilat ndajnë përvojat e tyre të shtrira në kohë dhe hapësirë, duke sfiduar me jetën që kanë jetuar dhe punën që kanë bërë, çdo paragjykim të ngritur në mijëvjeçarë se një grua nuk mund t'ia dalë mbanë përballë vështirësive. Në këtë aktivitet kërkimor, ato ishin narratore pa filtra të sfidave dhe barrierave me të cilat u është dashur të përballen në familje dhe në profesion, veçanërisht në këto dy periudha ndër më të vështirat në nivel kombetar dhe ndërkombëtar, si tërmeti i 26 Nentorit 2019, dhe pandemia

e COVID-19. Një vit pas fatkeqësisë natyrore dhe teksa pandemia ka mbërthyer globin, këto 8 gra tregojnë sesi kanë reaguar dhe në cilën mënyrë kanë kontribuar individualisht në mbështetjen e njerëzve të prekur nga tërmeti si dhe si kanë mbijetuar nga impakti që epidemia e koronavirusit solli në jetën familjare dhe ekonomike të secilës prej tyre. Të shikuarit të këtyre zhvillimeve transformuese në shoqërinë shqiptare, me sytë dhe mendjen e këtyre 8 grave, është një mënyrë për të prekur jetën e përditshme të çdo gruaje që nuk dorëzohet dhe gjen ende fuqinë për të luftuar në emër të parimeve në të cilat ajo beson: mbrojtjes së jetë dhe të njerëzve më në nevojë.

1.1. Qëllimi i studimit dhe pyetjet kërkimore.

Studimi orientohet nga një qëllim shumë specifik, që nxiti kështu gjithë organizimin e aktivitetit kërkimor. Qëllimi i referohet pasqyrimin real të roleve të gruas dhe ofrimi i kontributeve të saj në planin profesional për adresimin e problematikave përgjatë këtyre dy krizave historike. Hulumtimi mbi jetët e tyre familjare, ndërtimi i karrierës si dhe rrëzimi i paragjykimeve falë forcës së tyre ka qënë epiqendra e gjithë kërkimit. Qëllimi udhëhiqet nga tri pyetje kërkimore të mëposhtme:

- ▶ Me çfarë sfidash u është dashur të përballen gratë profesioniste pas tërmetit dhe gjatë periudhës së pandemisë së Covid-19?
- ▶ Në ç' mënyrë ato kanë ndihmuar, veten dhe të tjerët, në përballimin e pasojave që sollën këto 2 kriza?
- ▶ Çfarë perceptimi kanë ato për rëndësinë ose jo të mbështetjes bashkëshortore, në daljen mbanë të këtyre vështirësive?

Pyetjet kërkimore kanë qënë themelet kryesore në hartimin e udhëzuesve të intervistave gjysëm të strukturuar për 8 pjesëmarrëse që vinin nga fusha të ndryshme profesionale konkretisht: inxhinieri ndërtimi, gazetari investigative, mjekësi, shërbimi i policisë së shtetit, sipërmarrje e lirë, regji filmi, terapia e zhvillimit për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mësuesia. Në këtë kuadër është synuar të hulumtohet më thellë për të kuptuar sesi ngarkesa profesionale ka ndikuar në jetën e tyre personale dhe se si ato ia kanë dalë mbanë t'i menaxhojnë këto të dyja bashkë, duke qënë edhe kontributive në një periudhë të vështirë për shoqërinë shqiptare.

1.2. Metodologjia kërkimore e ndjekur në realizimin e këtij studimi.

Metodologjia që është zbatuar nga ana e kërkuesve është metoda cilësore me tipologjinë e narrativës. Qëllimi i kësaj metode është portretizimi i jetës së njerëzve, për të treguar se si përvojat e tyre ndryshojnë përgjatë jetës dhe për t'i lidhur këto përvoja me kontekstin social, kulturor ose historik brënda të cilit ato shfaqen. Historitë e jetës, përgjithësisht përdorin intervistat e thella për të mbledhur të dhënat. Ashtu sikurse është pohuar: “Cili individ është përzgjedhur nga miliona njerëz të botës për një studim kaq intensive?”, sigurisht që do të jenë njerëzit të cilët “janë të pasur me shumë informacione” – njerëz me përvojën e duhur, me gjëndje të brëndshme fantastike dhe që kanë histori për të treguar [Plummer (2001); cit. nga Rama&Tahiri&Sota, (2013)]. Në këtë kuadër, janë përzgjedhur me një kampionim selektiv ato personazhe të njohura dhe të spikatura në fusha të ndryshme, që sipas gjykimeve të kërkuesve, janë vlerësuar si persona të përshtatshëm për karakterin e këtij studimi. Informacioni është një pushtet absolut për kërkimin dhe rrëfimet e këtyre grave e kanë bërë këtë studim më të pushtetshëm nga pikëpamja e informacioneve dhe rezultateve të gjeneruara prej tij.

Hartimi i intervistave gjysëm të strukturuar ka qënë një proces shumë i rëndësishëm për të përgatitur pyetjet e duhura brënda kornizës së studimit. Bindja e pjesëmarrësve për t'u intervistuar ka marrë një kohë të konsiderueshme, sepse secila prej tyre në një periudhë kaq të vështirë si kjo e tanishmja, është përpjekur që të gjejë kohën e duhur për t'u impenjuar në intervistat online në platformën Zoom. Gadishmëria e tyre për të qënë kontributore në këtë studim ia vlen të theksohet, sepse ky është një tregues se një grua e gjen gjithnjë kohën për të folur për veten edhe në një periudhë si kjo kovidiiane.

Instrumenti kërkimor si ai i intervistës është hartuar në formë gjysëm të strukturuar, pikërisht për faktin se pjesëmarrëset vinin nga profesione të ndryshme dhe pyetjet janë formuluar në përputhje me profilin e tyre. Interpretimi i rrëfimeve të tyre përgjatë intervistave të regjistruara në fazën e transkriptimit ka ndikuar tek përcaktimi përfundimtar i numrit të pjesëmarrësve. Në studimet cilësore numri i pjesëmarrësve është një element subjektiv i cili varet drejtpërdrejtë nga ngopshmëria me informacion. Në këtë kontekst, ia vlen të theksohet gratë pjesëmarrëse nuk kanë qënë të rezervuara në asnjë moment për të shprehur një përjetim të tyre, një qasje personale apo një veprim të kryer në të kaluarën e tyre, sepse janë ndjerë shumë komode përgjatë takimeve të zhvilluara. Kjo ka ndikuar që studimi të furnizohet me informacione cilësore nga ana përmbajtësore.

1.3. Respektimi i konfidencialitetit dhe parimeve etike në kërkimin për gruan.

Udhëheqja e studimit nga parimet etike ka qënë një prioritet për kërkuesit. Autenticiteti i këtij punimi diktohet edhe nga fakti se nuk ka patur një studim te mirefillte pararendës për të njëjtën tematikë, kështu ky fakt e mbron këtë studim nga çdo mendim hipotetik për plagjiarizëm. Ruajtja e anonimatit dhe konfidencialitetit ka qënë një objektiv i rëndësishëm për etikën e kërkimit. Ruajtja e parimit të konfidencialitetit ka qënë një pikë referimi për studiuesit, në vend të emrave të pjesëmarrësve të studimit janë përdorur numra, për të koduar çdo të dhënë kompromentuese për vetë subjektet njerëzore dhe për emra të tjerë të përmendur prej tyre në intervistë. Format i dhënies së konfirmimit për intervistën ka qënë domethënëse për realizimin e këtij studimi. Dhënia e pëlqimit të informuar për intervistën është nënshkruar me pare nga pjesëmarrësit e studimit, pasi atyre iu janë komunikuar të gjitha detajet e studimit.

1.4. Karakteristikat demografike të grave pjesëmarrëse në studim.

Targetimi i popullatës së studimit është bazuar tek teknika e kampionimit selektiv në shkallë të vogël të pjesëmarrjes. Subjektet e kërkimit janë përzgjedhur në bazë të tri kritereve kryesore:

- ▶ Së pari, pjesëmarrësi në studim të ishte grua, pavarësisht moshës, ngjyrës, racës, besimit fetar, apo bindjes politike.
- ▶ Së dyti, gratë pjesëmarrëse të ishin personalitete të njohura dhe kontributore në vëndin e tyre gjatë dy krizave të forta.
- ▶ Së treti, të vinin nga profesione të vështira ku gjithnjë janë njohur si domein të burrave.

Nr.	Profesioni	Përvoja (ne vite)
1.	Inxhiniere	55
2.	Mjekë	6
3.	Mësuese	21
4.	Gazetare	21
5.	Regjizore/Skenariste	25
6.	Efektive e policies	5
7.	Terapiste e zhvillimit	7
8.	Punonjëse sociale	20

Kërkuesit janë kujdesur për ruajtjen e privatësisë për secilën prej grave të intervistuar, duke prezantuar vetëm dy elementë nga e gjitha pasqyra demografike e secilës prej tyre. Përvoja në vite është një karakteristikë kyçe e cila tregon një kohëzgjatje të konsiderueshme në profesion, me episode të njëpasnjëshme ku këto gra kanë përftuar eksperiencë dhe janë kthyer në modele referuese për ata/ato të rinj që janë në fazën fillestare. Vitet janë thjesht shifra, por përtej numrave, kërkuesit kanë evidentuar një pasion për punën tek këto profesioniste që ende nuk është shteruar.

II. ANALIZA E TE DHENAVE

Ne kete kapitull prezantohen skemat e rendesishme te gjeneruara nga faza e analizes se te dhenave. Pas transkriptimit dhe interpretimit te te dhenave, autoret e studimit kane ndertuar nje diagrame logjike ku ne te paraqiten te gjitha temat kyce. Korrelacionet logjike mes koncepteve jane burimi prej nga rrjedhin edhe gjetjet kryesore te studimit. Ne pjesen e dyte te kapitullit, autoret qe kane udhehequr studimin jane kujdesur te hartojne edhe dy piramida, njera qe perfaqeson 5 shanset te cilat ofron gruaja si ndaj institucioneve, kompanive,

prinderve, miqve, femijeve apo bashkeshorteve; ndersa tjetra ofron 5 problemet prioritare qe e cenojne figuren e gruas ne kontekstin shqiptar.

II.1. Diagrama logjike e temave.





Figura 1.2. Diagrama logjike

II.2. Hierarkia e pese problemeve prioritare qe ndikojne ne jeten e gruas.



Vështirësitë me karakter ekonomik ku gruaja drejtuese bën kompromise me stafin, ato me karakter teknik në situatat ku kontaktet fizike janë të pashmangshme, si dhe vështirësitë me karakter emocional në rastin e tërmetit, kur grate kanë shërbyer me ekspertizën e tyre në


Vetësakrifikimi është një problem thelbësor për gruan, sepse ajo nuk do të ndihet asnjëherë e plotësuar në të gjitha aspektet e jetës. Mes shumë të tjerash, një gruaje i duhet mbi të gjitha të sakrifikoj feminilitetin për të sfiduar burrat në profesion.

Puna me orare të tejjzgatura për gruan është një problem prioritar duke qënë se ajo ka shumë role për të menaxhuar në jetë.

Mungesa e mbështetjes së partnerit i bën edhe më të vështira sakrificat e gruas, kur ndodh që të mos mirëkuptohet nga bashkëshorti dhe ai të mos e ndihmojë nuk ndihmojë drejtpërdrejtë në menaxhimin e punëve të shtëpisë dhe edukimin e mirërritjen e fëmijëve.

Opinionit publik është një sfidë që vështirë të fitohet nga një grua. Perceptimet e gabuara të shoqërisë përbëjnë një barrierë më vete për gruan që ajo të jetojë siç dëshiron jetën e saj.

Figura 1.3. Piramida e problemeve.

II.3. Piramida e pese shanseve te qenies grua.

Jo burokraci, por ofrimi i zgjidhjeve konkrete dhe praktike në punë janë asete që i shërbejnë institucioneve dhe kompanive të ndryshme në menaxhimin e krizave. Puna e gruas e karakterizuar nga një stil inovativ në leadership dhe bashkëpunimi në grup, minimizon kostot e kompanisë

Empatia është një pike e forte për një grua që di si të qaset ndaj çdokujt në marrëdhënie pune. Di të jetë ekuilibruese në situata konfliktuale, duke ia dale të marrë më të mirën e mundshme në cfarëdolloj rrethane

Kontributore me përgjegjshmëri të lartë është një aset më vete për atë çfarë ofron një grua ndaj shoqërisë dhe vendit ku ajo jeton.

Menaxhimi i mirë i kohës bën që ajo të jetë efektive si ndaj familjarëve, fëmijëve, apo ndaj detyrimeve akademike dhe profesionale në kontekstin e punës. Pavarësisht shumë roleve që ka, gruaja nuk e humbet efektivitetin në përmbushjen e tyre

Qasja pozitive në këndvështrimin e gruas është një aspekt kryesor për t'i bërë mirë gjërat. Gratë ia dalin, sepse udhëhiqen nga optimizmi. Pandeminë e kanë parë si të qëndruarit më pranë familjes, si dhe të punëve produktive online.

III. REZULTATET E STUDIMIT

Në këtë kapitull paraqiten të gjitha gjetjet kërkimore që rezultojnë nga analiza e të dhënave cilësore. Autorët e studimit janë kujdesur që rezultatet të raportohen me objektivitet dhe pa asnjë ndërhyrje për t'i modifikuar ato. Gjetjet e këtij studimi përkthehen në kontribute shkencore të rëndësishme që do t'i shërbejnë kërkimeve pasardhëse në fushën e mbrojtjes së të drejtave të gruas dhe promovimit të rolit të saj në shoqëri. Format i prezantimit të rezultateve të studimit shoqërohet me përshkrimet e pjesëmarrësve duke ruajtur anonimat e tyre në mbështetje të kodit etik të metodologjisë kërkimore. Gjetjet janë të organizuara sipas temave të gjeneruara në fazën e analizës së të dhënave.

III.1. Prirja e grave drejt profesioneve me karakter sfidues.

Nga analiza e të dhënave është identifikuar se gratë kanë tendencë për të mbizotëruar në ato fusha profesionale, ku prëzgjithesisht prëzenca e burrave është e pashmangshme. Në profile të tilla si gjeoteknika e inxhinierise, kronika e zeze e gazetarise, regjia në kinematografi, mjekët reanimatorë, apo sherbimi i policise së shtetit, mund të themi se është përmbysur raporti mashkull-femer. Gratë kanë dashur të dominojnë me profesionalizem, me dëshirë dhe pasion për punën, me përgjegjshmeri dhe korrektesinë kundrejt asaj cka marrin për siper. Ky aspekt reflektohet në pasazhet e mëposhtme:

- *“Kur më prezantuan që do të merresh me fëmijët me aftësi ndryshe, nuk e di më lindi një feeling. Domethënë kisha shumë dëshirë të merresha me ta. Ishte diçka e panjohur për mua, dhe duke qënë se ishin fëmijë dhe duke menduar se këta kanë më shumë nevojë për mua sesa fëmijët me zhvillim normal le të themi. Ishte krejt e rastësishme, shumë e goditur mendoj si zgjedhje, që në fillim fare i desha shumë këta fëmijë me aftësi ndryshe” (Pjesëmarrësja 2).*
- *“Atëherë të Katedra e Konstruksioneve arritëm që atje të kemi gjysëm për gjysëm stafin, gra dhe burra. Ndoshta tani në këto vitet e fundit, nxjerrin këto specialistët e gjeoteknikës. Po ka më shumë vajza se vajzat preferojnë shumë që...a të punojnë me*

mua, a nuk e di si është puna, po domethënë (qesh) tek unë, që është një profesion shumë i vështirë, është më i vështiri nga të gjitha në inxhinieri, gjeotekniku është më i vështiri, ka më shumë vajza se sa djem” (Pjesëmarresja 8).

- *“Tendenca ka ardhur që mjekësia ka shumë femra. Tendenca ka ardhur që anestezia ka shumë femra, dmth edhe në brezin tone kemi patur një raport 2 me 1 ose 3 me 1 në krahasim me meshkujt. Keshtu që, nuk e di pse meshkujt filluan të merrnin deget me te lehta, reumatologjia apo çfare ishin...alergologji. Dhe nderkohe kishte femra që merrnin profesionet me te veshtira” (Pjesëmarresja 4).*
- *“Në vetvete policia është shumë e vështirë. Polic edhe lind, se duhet të kesh edhe nuhatjen në çfarëdolloj situatë që të jepet. (Pjesëmarresja 6).*

III.2. Vështiresitë e natyrave të ndryshme në kontekstin e punës përgjatë periudhës së pandemisë COVID-19.

Nga analiza e të dhënave ka rezultuar se gruaja në rolin e sipërmarrës, drejtueses së një organizate apo të një institucioni, në funksionin e raportueses në terren apo terapistes së zhvillimit kanë patur probleme me karakter ekonomik, teknik, psiko-emocional në perballimin e vështiresive të ndryshme në mjedisin e punës. Kompromisi në kurriz të cilesisë së punës është një fjalë që një grua perpiqet ta shmang në çdo drejtim të jetës së saj, pasi perpiqet të ruaj me çdo kusht skrupulozitetin e saj. Por në situatë krizash sikurse pandemia, gruaja është vendosur përballë dilemave etike të forta, duke u përparë që të zgjedh të keqen të vogël në funksion të moskompromentimit të rezultatit të punës së saj të përditshme. Ja si shprehen gratë e intervistuarat në lidhje me disa aspekte që solli pandemia në punën e tyre:

- *“Kam qarkulluar me shohin me fytyrën jashtë. Nuk mundet që unë të dal me një maskë, e mbuluar vetëm me sytë, sepse tek ata ka shumë rëndësi pjesa e të lexuarit të buzës. E lexojnë. Domethënë, edhe atë maskën transparente që mund të vë, është e*

pamundur që ta mbaj maskën sepse ata nuk më shohin dot. Do i dukem nje njeri ndryshe, nuk do jem e nejeta që ato janë mësuar përgjatë këtyre viteve” (Pjesëmarresja 2).

- *“Ne fakt, padyshim që pandemia ka ndikuar. Qoftë në fonde, në devijimin e fondeve që mund të jepeshin për organizatat dhe që nuk jepen më. Perpara se të ishte pandemia, kishte dy call for proposal, por në u përfshim në dhenie mendimesh që do të dilnin dicka nga Marsi apo Prilli dhe nuk dolën kurrë. Një call tjetër për proposal ishte nga vera dhe ajo u anulua, kështu që patjetër që ka ndryshuar perspektiva për shpërndarjen e fondeve, shpërndarjet e pritshme të fondeve, por nderkohe ka ndikuar edhe në mënyrën e punës të atyre fondeve aktuale që tani ke, në zbatimin e atyre që tani ke, sepse është vështirësuar puna. Tani nuk kryejmë me takime balle për balle, puna në terren është bërë e frikshme, sepse mos infektohen stafit, mos ka probleme, kështu që është një stres i shtuar” (Pjesëmarresja 7).*
- *“Në ende si industri nuk kemi takuar me njëri-tjetrin që të reflektojmë. Institucionet tona bazike, marrin një copë të shkruar siç e kam marrë unë nga Ministria e Shëndetësisë, e marr dhe ai, por nuk është se po shikojmë me seriozitet se si do ia dalim. Nëse Gjermania është e para dhe po ndihmon performuesit, kineastët dhe të gjithë sektorin e artit, sepse e di çfarë rëndësie ka, në deri më sot, unë nuk kam dëgjuar asnjë masë se si do ia dalin qytetari dhe artisti shqiptar. Kështu që unë kthehem edhe njëherë për ndërtimin otomanët pesë shekuj. Në ende nuk e kemi fuqinë e reflektimit që diçka e madhe ka ndodhur dhe jeta nuk do jetë më e njëjlojtë. Në ende merremi me sikur, dhe unë nuk e di, kur të futësh në një shesh xhirimi sa mund të dalin të infektuar, sa të ndërjegjeshëm jemi në që duhet të reagojmë ndryshe, dhe unë nuk e di kur ne do dalim nga kjo situatë” (Pjesëmarresja 5).*
- *“Ka një angazhim, sepse tani duhet të përgatitesh atë të cilin do të duhet ta bëjë në klase përmes zërit tënd, ose përmes tabelës së zezë, nderkohe tani të duhet të përgatitesh për përpunimin, të vecosh atë njohuri me të rëndësishme për nxënësin, maksimumi 40 minuta mund të rrijë do të duhet të riktheheshe në 40 minuta të tjera, kështu që unë mendoj që angazhimi është shumë i madh. Duhet të mendosh detyra të tjera, por jo të besh detyra sikur je në klase, por duhet ta pershtatesh me situatën që ai ta shkruaj në kompjuter. Po kështu, edhe testi që do të besh prapë duhet ta pershtatesh me një format të ri” (Pjesëmarresja 1).*

- *“Eshte e veshtire, sepse profesioni jone ka roje pafund, profesioni mbulon te pakten po flas per QSUT, ti ke disa reanimacione ne neurokirurgji, ne kardiokirurgji, ka urgjenca pafund. Ne cdo profesion ka urgjenca e veta, por ne jemi gjate gjithë kohe ne urgjence. Ndryshon nje mjeke - roje qe ben ne nje pavion me nje roje qe bejme ne. Nje mjeke roje ne pavion mund te therritet nje ose dy here maksimumi gjithë naten ne urgjence, nderkohe qe ne kalojme pjesen me te madhe ne urgjenca si ana kirurgjikale, si ana medikamentoze” (Pjesemarresja 4).*
- *“Nxenesit vendosin maskat. Ishte shume e veshtire ne dy javet e para. Per mua te pakten ka qene, sepse te shpjegosh me maske ka qene...mua me futej dicka e nxehte ne mushkeri” (Pjesemarresja 1).*
- *“Jo vetëm në pjesën e ndërveprimit social që u goditëm, sepse nuk duhet të rrinim, nuk duhet të komunikojmë, që të mos jepen dora, distanca që duhet mbajtur, por në kushtet e mia të punës, të punosh me fëmijë me nevoja të veçanta është e pamundur të ruash distancën, të ruash kontaktin, sepse ata vijnë të hidhen në qafë, nuk e kuptojnë kur ti u thua “më qëndro larg se është Covid-I” (Pjesemarresja 2).*

III.3. Forca e gruas per rrezimin e paragjykimeve ne profesionet me karakter maskil.

Nga analiza e te dhenave ka rezultuar se grate pjesemarrese ne kete studim kane shprehur qendrimet e forta perkundrejt perceptimeve te shoqerise “ajo nuk mund ta beje se eshte femer”. Pjesemarreset kane tejkualuar pritshmerite e vetvetes dhe kane rrefyer pervojat e tyre ne jeten profesionale:

- *“Thuajse Policia e Shtetit ka 25% të gjinisë femërore, dhe janë pritur shumë mirë domethënë në polici, edhe në komunitet, pasi femra është ajo që edhe në komunikimin e parë zbut situatën, domethënë që të vëjë ekuilibra në çfarëdolloj komunikimi që merr me qytetarët apo me komunitetin ku ajo punon” (Pjesëmarresja 6).*
- *“Paragjykimi mund të ekzistojë, megjithatë vajzat inxhinierë që donin të punonin, kanë shkuar kanë punuar nëpër zyra. Kanë punuar në vepra gjigande. Kanë punuar në Kombinatin Metalurgjik, që ishte gjigand. Kanë punuar në objektet e godinat civile, në veprat industriale, ku s’kanë punuar. Përveç se instituteve të projektimit që ato vetë ishin gati gjysëm për gjysëm, mos themi një çikë më shumë kishin personel gra se sa burra. Domethënë më tepër gjini femërore se sa gjini mashkullore. Punohej shumë mirë. Vajzat punojnë shumë mirë. Shumë serioze në punë janë. Dhe në këto 30 vjet që kanë ndryshuar sistemet, që është ekonomia e tregut, prapë vajzat janë më të përgjegjshme. Shumë më të përgjegjshme. Domethënë nuk bëjnë numra, budallallëqe në punën e tyre. (Pjesëmarresja 8).*
- *“Sepse kronika e zeze ishte një fushe e burrave, ishte një fushe e cunave dhe kur thoje kronike e zeze e mendonin njëherë dhe thonin “kjo nuk e ben dot, do ulet e do flas me ore te tera, a do te flasi dot me policat etj.” ...Gazetarja femer ne kete rast sic isha une, jo domosdoshmerisht duhet te ndiqte keto shabllone, kupton? Shikohej si nje fushe e burrave, sepse kishe te beje me pjesen me te veshtire te shoqerise. Kishe te beje me nje shoqeri maskiliste sikurse ishte policia, edhe policia nga ana tjeter ishte po keshtu. Nderkohe do te duhej te merreshe me persona qe kishin probleme me ligjin. Edhe sot te hyje ne burgje, duhet te maskilizoresh pak ne menyre qe te mos behesh objekt diskutimi dhe mos te te shikojne si gazetare femer. Po te them raportin e sotem, kane hyre me shume femra se meshkuj ne kroniken e zeze” (Pjesëmarresja 3).*

III.4. Ofrimi i kontributeve profesionale te grave ne periudhen e post-termetit dhe gjate pandemise.

Gjate perpunimit te te dhenave te perftuara nga intervistat, u konstatua se grate pertej jetes familjare kane arritur te jene kontributore ne adresimin e nevojave te individeve te prekur nga termeti. E njejta gje ka ndodhur edhe ne rastin e izolimit diktuar nga pandemia e COVID19. Te teta pjesemarrest ne kete studim kane shprehur nje qasje individuale, jo vetem profesionale, por edhe njerezore duke u perpjekur qe t'i gjenden prane kujtqdo qe kishte nevojë per ndihme. Kjo duket veccanerisht ne pergjigjiet e meposhtme te te intervistuarave:

- *“Ka patur familje qe me janë lutur në karantinë ta bëjmë terapinë fshehurazi, sepse u trajtua sikur kishim bërë krime. Këta janë prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe qe e kanë të detyrueshme të dalin, të çlirojnë energjitë e tyre. Domethënë ata vinin fshehurazi. Vinin tek shtëpia ime. Ndiqnin seancën e terapisë, dhe janë në fakt prindërit qe nuk e kanë ndërprerë kurrë edhe përgjatë periudhës së pandemisë” (Pjesemarresja 2).*
- *“Ate dite nuk kemi bere asgje. Diten tjeter kemi filluar te perfshihemi e te bejme gjerat dhe filluan edhe telefonatat, jo kishin nevojë per karrige me rrota, jo kishin nevojë per sherbimin qe ne ofrojme, qe filluam te levizim. Edhe kjo ka qene edhe gjate festave te Nentorit, kemi qene te angazhuar ne ato zona qe ishte nevoja. Kishte nje kerkese te shtuar ne ate periudhe ndaj sherbimit per personat me aftesi te kufizuar, neper fshatra qe ishin demtuar, mbase ishin edhe demtime te perkohshme, mund te kete pasur rreth 60 persona ne ato 2-3 dite” (Pjesemarresja 7).*
- *“Më është krijuar mundësia që të flas në Kongresin e Arkivave Televizive dhe dua të ngre fonde për të shpëtuar muzikën e filmit shqiptar, që është një nga momentet më të mira të filmit tonë, edhe përgatita një tre minutësh për prezantimin, se dihet që do jetë online. Kongresi do jetë online. Edhe u fokusova vetëm në aktivitetet e 2020-ës dhe të mendosh që çfarë kemi, flas në aspektin e punës reale, jo në evente shtypa play diku, pashë një film, por gjëra reale që kemi bërë këtë vit, të ikën pak mëndja, kështu që edhe njëherë kthehem tek puna. Nëse ti do, edhe pse ka qënë kaq e vështirë tërmeti, kaq e vështirë korona, në një vend me mungesë profesionistësh, me mungesë fondesh, prapë edhe këto kohë të vështira, kush ka dashur ka arritur dhe ka punuar. Po*

shkatërrohem fizikisht, po ua nxij jetën atyre të mive, po e vërteta është që kemi bërë punë kualitative. Prandaj them, duhet shikuar përtej justifikimeve ku janë gjërat reale” (Pjesëmarresja 5).

- *“Kishte telefonata jashtë mase shumë. Kishte krisje nëpër pallate, nëpër banesa. Kishin frikë. Ishin në gjendje ankthi. Ne shkonim, merrnim takim. Po nuk jemi ne inxhiniera që ti shikonim, se filluam duke bërë dhe rolin e inxhinierit, se punonjësit e policisë po marrin detyra si të hidraulikut, si të inxhinierit...Ne s’kishim ç’ti bënim. Po na shikonin me një sy që “Filmoje këtu, fotografoje këtu”, që t’ia çonim minibashkisë, po nuk është se ne kishim gjë në dorë” (Pjesëmarresja 6).*
- *“Kështu që, në rastin e tërmetit, meqënëse unë jam e kësaj fushe, domethënë të fushës së ndërtimit dhe të gjeoteknikës që lidhet shumë ngushtë me tërmetet, u mundova si profesioniste, nuk e kam fare qejt që të dal nëpër ekrane, por meqënëse më ftuan në ekran, e shpjegova aq thjeshtë sa munda ta shpjegoj një fenomen që është shumë i komplikuar, që njerëzit ta kuptojnë dhe të mos kenë atë panik sepse paniku është i tmerrshëm. Kur të kap paniku, qoftë në rastin e parë, qoftë në rastin e dytë, paniku bën që të ulet imuniteti i njeriut, ulet rezistenca e njeriut dhe kjo gjë, në rastet e tërmetit, kur të zë paniku ti nuk je për asnjë gjë. Për asnjë gjë fare! As për shtëpinë tënde, as për familjen tënde, as për punë e as për gjë (Pjesëmarresja 8).*
- *“Nga termeti une kam ngelur pa shtëpi (qesh ne siklet e siper), termetin e kam pjese emocionale timen dhe personale, por jo nuk kam qene ne pune; sepse pjesen e termetit e perjetoj ime me shume keq. Kuptohet qe per nje grua qe na ka rritur e vetme, dy vajza, dmth., e kishte tmerr pjesen e termetit. Qe gjithë kursimet e nje jete i ka tek nje shtëpi, keshtu qe kam qene me mamin ne ato dite te para. Kam qene kontribut per nenen time, per familjen time, per njerezit e mi” (Pjesëmarresja 4).*
- *“Vetem nje parim, interesi publikut i cdo qytetari. Kur ishte termeti thosha cfare i intereson atij qytetari qe eshte prekur nga termeti ne Durres? Shtepia. Ku do te fleje sonte? Cfare i intereson qytetarit ne kete situatë pandemie? Informacion i shendetshem, pa panic, shume i konfirmuar, jo toksik. Informacion per publikun, ne interes te publikut. Vetem kete kam menduar, sa here kam trajtuar nje histori kam thene, dakord, po qytetarit qe eshte ne Sarande cfare do t’i interesonte ne rastin e pandemise dhe termetit, perse duhet ta shikoje kete gje (Pjesëmarresja 3).*

- *“Mesuesi nuk ben dot rolin e indiferentit, edhe ne kohen e pandemise p.sh., une do ta kisha shume te lehte qe kur te beja oret e Zoom-it ta mbaja kameren te fikur, t’iu vendosja atyre vetem nje video. Dhe vete nderkohe te beja dicka tjeter, sepse video fale Rtsh shkolles kisha plot, por nuk e kam bere asnjehere kete, sepse cdo ore e humbur pa mua aty ne ekran, permes zerit tim, permes keshillave te mia, permes ndihmes time ...” (Pjesemarresja 1).*
- *“Një muaj rresht, gjithë dhjetorin, bile dhe një pjesë të janarit, unë nuk kam pushuar së shkuari kush më thërriste. Nuk i njihja fare njerëzit. Unë atë e kisha një detyrë qytetare dhe njerëzore. Nëqoftëse njerëzit i paskam qetësuar kaq shumë sa thoshin “Po s’na erdhi ajo, ne nuk futemi në shtëpi”. Kështu që, ku nuk kam shkuar. Domethënë, në Tiranë, cep më cep. Në Durrës po, në Golem po, në Lezhë kam shkuar, në Fushë Krujë kam shkuar, në Bubq kam shkuar, ku nuk kam shkova! Në Thumanë shkova, gjithandej”(Pjesemarresja 8).*

III.5. Gruaja perballe moshes si faktor biologjik.

Nje tjeter aspekt qe ka dale ne pah gjate analizes se te dhenave eshte te vendosurit e gruas ne nje beteje te perhershme me moshen dhe me mentalitetin per menyren sesi konceptohet mosha e nje gruaje, ne kontekste te caktuara, te cilat shpesh shendrohen ne pengesa jorealiste per arritjet e gruas. Megjithese mosha eshte nje medalje me dy faqe, pasi vitet qe kalojne, ndikojne ne menyre te terthorte ne uljen e rendimentit me kohe te sterzgjatur ne pune, sikurse pohon dhe nje nga grate me poshte:

- *“Para 5-6 vjetesh si duket me kalimin e moshes, nuk rri dot me nga 20 ore ne pune. Pati nje renie energjie, ishte e pamundur, me zinte gjumi ne karrige” (Pjesemarresja 7).*
- *“Ura komunikimi, ura bashkëpunimi, kam patur shumë më të lehta dhe ndihem shumë komode në bashkëbisedim me meshkuj sesa me gra. Nuk e di, shoh një tendencë paragjykuese tek gratë. Shoh një tendencë pasigurie ose efekti i moshës. Gjithmonë më kanë vënë në dukje efektin e moshës, dhe mua më është dashur gjithmonë që në prezantim me ta, ta rris moshën. Domethënë tek*

gratë vuan dhe presionin e moshës. Si ka mundësi që ti je kaq e re dhe kaq e cilësuar, të krijosh diçka tënden, ose të mbash diçka tënden” (Pjesëmarresja 2).

- *“Dhe sa kohë që unë jam shëndoshë e mirë dhe truri më punon, pavaresisht moshes, unë do vazhdoj të punoj. Do vazhdoj të punoj jo me atë ritmin që kam punuar më përpara, se sepse mosha bën të vetën, po unë sa të kem frymë do vazhdoj të punoj në punët që më japin shumë kënaqësi. Në punët me studentët, në punët kërkimore, në shkrimin e librave, në artikuj dhe vëllime të ndryshme që i çoj në konferenca të ndryshme në të gjithë botën. Kështu që, unë do vazhdoj të punoj, të ndihmoj kush më kërkon mendimin tim ose eksperiencën time për ndonjë problem” (Pjesëmarresja 8).*
- *“Mosha e re ndikon, në moment që ato shikojne një moshe të madhe janë të bindur që absolutisht një person që ka me shume eksperience di me shume” (Pjesëmarresja 4).*

III.6. Refuzimi i burokracive dhe orientimi drejt zgjidhjeve konkrete.

Ne dallim nga paragjykimi seksist i krijuar ndër vite se meshkujt karakterizohen nga praktikiteti ndërsa gratë priren drejt nderlikimit të situatave, e verteta është se gratë nën petkun e punonjësës së administratës së shtetit pranojnë se nuk e kanë dashur kurrë burokracinë. Në analizen e të dhënave rezultojnë se pjesëmarreset në këtë studim kanë qenë ngahera në kërkim të alternativave që çojnë në zgjidhje konkrete dhe jo në zvarritje në emër të burokracisë. Ja si e përshkruajnë gratë e intervistuarat punën e tyre në një sektor publik:

- *“Punoja në një sektor që ishte e fokusuar në politikën për parandalimin e drogës, alkoolit, por ishte një punë në Ministrinë, një punë shumë zyrtare, shumë burokraci, unë nderkohe isha e re atëherë dhe thoja “O Zot ç’është kjo punë kështu? Si kalon dita duke pirë kafë?”, kështu që në momentin që m’u ofrua kjo mundësi, e provova dhe nuk u ktheva më” (Pjesëmarresja 7).*
- *“Prandaj ju them që po të isha një qytetare e thjeshtë, rrogëtare e thjeshtë, mos isha kineaste, mos isha regjizore, mos isha diplomuar ku jam diplomuar, mos kem bërë rrugëtimin që kam bërë, ndoshta dhe unë do pranoja që këtij institucioni i pikon*

çatia, nuk ka asgjë, nuk ka fonde, kështu që po fus rrogën, po bëj sikur, sikundër është bërë. Po në fakt unë di më mirë. Unë di që filmi po na vdes ndërsa ne flasim, dhe po nuk bëme diçka në 10 vitet e ardhshme, edhe të vijnë fondet nga Rio de Janeiro, do zhduket trashëgimia. Kështu që unë kam një cloth tjetër, kam një përgjegjësi tjetër prej njohurive që unë kam” (Pjesëmarresja 5).

- *“Padyshim që po. Cdo gje mund të behet online. Shkolla vete mund të ketë aksesin e një platforme digjitale të veten, mund t’i ruajë aty dokumentet. Une jam trajnuar disa here qofte për regjister elektronik dhe mesuesi ka aksesin për të hedhur noten në regjistrin elektronik. Prindi mund t’ia shikojë vete nga shtëpia noten e nxenesit. Nuk është që ne po e bëjme për here të pare. Keto i ka bërë bota përpara nesh. Cdo komunikim sot është online. P.sh., unë kam qene në një trajnim në Itali në Milano dhe shkolla në të cilën vizitova unë kishte një sekretari me 3-4 sekretare që mesuesi nuk merrej fare me burokraci të lekeve të dorezimeve, ajo që ishte kryesore dhe thelbesore për mesuesin ishte të merrej me auditorin” (Pjesëmarresja 1).*
- *“Na vjen i komanduar shefi i policëve me komunitetin, një epror tjetër. Dhe duke e përcjellë për në shtëpi, rastis, neve ishte kjo situatë që nuk lejohen grumbullimet dhe dasmat. Dhe pranë banesës së tij po zhvillohej një...kishte muzikë dhe po kërcenin familjarët. Dhe më thotë “Zbrit dhe gjobë!”. I thashë...”A e dëgjon”, më tha mua, “Ka muzikë”. “Po mo ka muzikë, do ta fikin se ska ndonjë gjë”. “Ee ashtu...” (qesh). Pastaj më tha mua “Vëri gjobë!”. “Si mund ti vesh gjobë?”, i thashë unë, “Le që nuk jam në sektorin tim”. Domethënë duhet të reagosh se jo çdo urdhër ti duhet ta zbatosh. “Unë nuk jam në sektorin tim”, i thashë, “përgjegjësinë e ka ai që është në sektor dhe jo unë” (Pjesëmarresja 6).*

III.7. Vetesakrificimi si karakteristike perfaqesuese per gruan.

Nga analiza e pohimeve të grave të intervistuar kupton sakrificën e madhe që i është dashur të bëjnë për të arritur vetë-realizimin profesional por edhe të përgjigjen përballë sfidave që solli termeti dhe pandemia. Secila prej tyre shfaqet e ndergjegjshme për keto

sakrificat, duke mos fshehur perjetimin njerezor qe kane provuar kur jane ndodhur perballe vendimeve te veshtira, shpeshhere edhe me karakter vetemohues, qe vetem nje grua mbase do te kishte forcen per t'i bere.

- *“E them me dhimbje kur gjithë kjo, nuk mund të them pavarësi, nevojë mund të them, nuk kam dalë në emër të pavarësisë të bëhem femër e pavarur, të jem e barabartë me meshkujt, është nevoja që na nxjerr të punojmë përditë, sepse kur bëhesh nënë, është shumë më ndryshe. E shikon domethënë dhe veten më ndryshe, e shikon dhe gjithçka rreth e rrotull teje më ndryshe. Unë nëse bisedoj me ju, mëndja më rri tek vajza” (Pjesëmarresja 2).*
- *“Në rastin tim, për shembull, është që unë nuk mendoj me nivelin e përgjegjshmërisë që unë kam, që unë mund të bëja mirë edhe ato që unë di të bëj mirë edhe të rrisja një fëmijë. Domethënë, duke njohur natyrën time dhe duke njohur që jam e përgjegjshme, dhe duke njohur ëhat it takes, çfarë merr kur ti di të bësh mirë diçka, unë nuk e dija nëse mund ta menaxhoja që të kisha liri...” (Pjesëmarresja 4).*
- *“Une mendoj qe kompromisi me i madh qe ben gruaja, qe lidhet me natyren e saj eshte te sakrifikuarit e vetes. Po une cfare kompromisi kam bere per te ruajtur pavaresine? Po te shikosh statusin personal...(pauzë). Tani, une kam bere nje kompromis, kam dhene kohe me shume sec duhet, edhe nga jeta personale. P.sh., e supozojme, pjesa dërrmuese kur merren me gazetari a mirekuptohen ata kur lidhen me nje partner apo partnere jo gazetar? Mua nuk me mirekuptojne njerezit e shtepise ende” (Pjesëmarresja 3).*
- *“Mua me dukej me e dhimbshme kur kolegeve te mia qe nuk i pane femijet per nje muaj. Une kisha shume goca si infeksioniste, si mjeke reanimatore, qe vendosen femijet t'i lenin me prinderit, jetonin vetem me bashkeshortin, ose vetem qe te mos takonin, te mos infektonin, sepse eshte frika. Sepse une kam qene ne salle me mjeket e mi me te medhenj dhe te te marri femija ne telefon, te te qaj e te te thote qe: “te lutem hajde ne shtepi sonte”, dhe ti te mos kesh mundesi te shkosh...”(Pjesëmarresja 4).*
- *“Domethënë nëse unë do doja të bëja diçka ndryshe do doja të kisha më shumë kohë për vajzën. E kuptoj që asgjë s'ka vlerë. Fundja fundit gjëja që do i mungojë më shumë vajzës sime është koha me mua, dhe mua më dhëmb kur kthehem pas në kohë,*

kur kuptoj që ditët ekin, orët, çasti, ose kur i jap puthjen e mëngjesit dhe thotë “O mam, do shihemi natën, se unë e di që me ty shihem vetëm natën”, dhe e vetmja gjë që do doja të ndryshoja kjo është. T’i dhuroj më shumë kohë vajzës dhe (qesh) nuk di çka të shpreh më (Pjesëmarresja 2).

- “Po, mami e ka perjetuar tmerresisht shume keq. Me takikardi, me nje frekuence 170, per cdo lekundje u trembte. Mamin e kam qetesuar vetem me diazepam gjate gjithe kohes. E ka kaluar pak, por keshtu...une nuk u nisa, im shoq eshte ne France per nje specializim, une nuk mund ta lija ne ate periudhe vetem ne Durres” (Pjesëmarresja 4).
- “Ideja eshte ketu qe, dmth kur ti nis dicka dhe ishin situatat rresht. Isha drejtoresh, pastaj me duhej te beja edhe nje Master. Dmth keto kane qene problematikat qe kur donim ne, ishte e pamundur qe te benim edhe nje femije tjeter. Keshtu qe, reshtem. Por eshte kompromis i gabuar teresisht, edhe une kolegeve iu them vazhdimisht qe duhet me patjeter te kesh 2 femije, tre femije ne jete” (Pjesëmarresja 1).
- “Problemi yne ishte se nuk kishim staf te ri, une e quaja veten me mire te punoja une, se sa te punonte nje shef i imi qe ishte kardiopat, dy here infarkt, me 3 stenda ne zemer, keshtu qe edhe sikur te viheshe emri i atij ne roje, do ia beja une. Absolutisht qe nuk e kam patur tek kjo pjese, sepse ka qene gjithmone tendenca per te ndihmuar njeri-tjetrin” (Pjesëmarresja 2).

III.8. Niveli i larte i empatise ne profesion si forme pershtatjeje e gruas ne mjedisin ku ndodhet.

Nga analiza e te dhenave eshte evidentuar se gruaja e ka shume te theksuar empatine ne jeten profesionale, por kjo jo si dobesi, perkundrasi si aspekt avantazhues pasi gruaja e perdor ne funksion te te pershtaturit me mjedisin ku duhet te punoje per te arritur objektivat e saj. Megjithese ka pasur edhe raste kur empatia e tepert e ka demtuar. Grate tregojne si me poshte:

“Nëse krijoj empati, shpesh herë më ka dëmtuar. Kjo empatia e tepërt kundrejt të tjerëve mua më ka dëmtuar” (Pjesëmarresja 2).

“Kur ishim te protesta e minatorëve, ajo ishte më e freskët, se ndodhi para një muaji, domethënë...jam munduar...e kam shpëput kordonin. Jam larguar, dhe kanë kaluar zonjat. Sado që kolegët shtynin, unë jam larguar. Nuk mundesha. Ato po kërkonin të drejtën, kërkojnë bukë” (Pjesëmarresja 6).

- *"Dhe une kam takuar gra qe mund ta kem kaluar edhe ate kufirin profesional, qe do te thote p.sh., njera qe ishte e dhunuar ajo dhe ai e rrahu edhe publikisht ne nje qender tregtare dhe une kete e kuptova se shpesh fliste per vetvrasjen, edhe po e thoshte si ne vet te trete, por ne fakt e thoshte per veten e saj. Dhe aty mbaroi gazetarja dhe une kam marre nje psikologe qe ta ndihmonte, se e kuptova se ishte ne situatë shume dramatike.*
- *“Kam patur rastin e nje vajze qe ishte abuzuar seksualisht nga i ati qe ajo u braktis nga e ema dhe vellezerit i thoshin: “ti na turperove, terhiq kallezimin!”. Edhe per kete vajze une e kalova prape ate kufirin e gazetares dhe i kemi gjetur vend per t’u strehuar qe ajo te vazhdonte jeten e saj” (Pjesëmarresja 3).*
- *“Po si të mos jemi të prekur kur ti shikon studentët?! Ne kemi kolegë që i kanë fëmijët në universitete. E di sa e vështirë është pagesa, ose ti mohosh të drejtën për të studiuar në një universitet dhe të mos kesh mundësi ekonomike. Dhe kolegët tonë që kanë fëmijët nëpër universitete e përjetuan shumë keq të them të drejtën. Edhe i mbështesnin. Shpesh herë na është dashur që kordonin ta hapim dhe vetë” (Pjesëmarresja 6).*
- *“Kam pershtypjen jane femrat me shume, sidomos kur kemi vajza gravide me semundje te tjera shoqeruese, keto ishin dmth mbas lindjes qe na vinin atje, keto i perjetoj shume. Vajzat qe mund t’iu kete ndodhur dicka ne periudhen e leonise e keto jane gjera qe ti i perjeton (Pjesëmarresja 4).*
- *“Ne bejme nje audicion per te fituar rolet kryesore. Dhe ne fakt ishim ekip, pra qe vendosnim rolet bashke me koleget e tjera te departamentit. Kur mbarojme dhe perfundojme detajet e fundit te konkurrimit, dalim nga salla dhe e shikojme kete djalin qe jo qante, por kam nje ide qe do te ishte mekur nga ideja e mos-fitimit te rolit....Tani, ti vendosesh perball dy situatave, sepse nuk eshte kaq e thjeshte. Ti, vertete nga njera ane je njerezore, pervec se je nene, je mesuese dhe pjesa qe te shikosh nje femije duke*

qare dhe te mendosh qe ai e do kaq shume dhe ti te niseshe e t'i thuash : "Po, do ta fitosh". Por duhet te mendosh edhe nga ana tjetere, po si mund t'ia japesh kete rolin, cfare do i mesosh qe nese ti do ben keshtu, atehere ti do ta fitosh rolin. E diskutojme kete me koleget dhe i them t'i japim nje mundesi tjetere" (Pjesemarresja 1).

- *"Kam trajtuar nje ekskluzive per te denuarit e perjetshem edhe ne burgun e Peqinit eshte nje sektor qe quhet sektori A dhe eshte sektori me parametrat me te larta te sigurise; aty natyrisht edhe sociologet ishin meshkuj, psikologet ishin meshkuj dhe ne hyme aty dhe e vetmja femer isha une. Doli nje nga keto te denuarit e perjetshem qe ishte i bandes X dhe ai vjen aty dhe me zgjat cigaren (eshte i denuar i perjetshem) edhe une ne nje moment...ai po me priste sipas rregullave te tij te burgut, sipas traditave qe kane te burgosurit burrerisht dhe une kam reaguar sikur keshtu "faleminderit vlla". Dmth une te gjitha te denuarit e burgut te perjetshem derisa kane mbaruar xhirimet, i thosha "vlla" njerit "vlla" tjetrit dhe ne fakt asnjerin nuk e njihja. I thosha "vlla" per te krijuar kete klimen me kupton" (Pjesemarresja 3).*

III.9. Realizimi i punes ne orare te gjata si mbingarkese psiko-fizike per gruan.

Nje tjetere sfide qe del ne pah per gruan eshte ajo e te punuarit me ore te gjata. Nga analiza e te dhenave cilesore eshte percaktuar se gruaja ndikohet nga qendrimi me kohe te te zgjatur ne pune duke cenuar ekuilibrat e jetes se perdritshme duke qene se tek ajo mbeshteten nje seri rolesh. Sidomos ne fillimet e punes se tyre, qendrimi me mbi 16 ore thuhet se ka qene i mireqene ne secilen nga profesionet e grave te intervistuar.

- *"Me ka perkrahur, ne vitet e para me ka perkrahur shume, sepse ishte me te vertete e veshtire. Ne vitet e para dilje nga shtepia ne 8 te mengjesit e ktheheshe ne 9 te darkes" (Pjesemarresja 8).*
- *"Merremi me dhomat qe quhen dhomat e ndalimit ku behet shoqerimi i personave qe rrijne me shume se tre ditë. Po themi keto qe jane me vepër penale për dhënien e mjetit në gjendje të dehur, apo fallsifikimin e dokumentacioneve, domethënë gjëra të tilla, dhe themi si do t'ia arrijmë t'ia dalim se duhet të rrish brenda tetë orë bashkë me to, edhe jemi vetëm tre vajza, dhe do të na vijë*

më shpesh shërbimi për të kryer në atë drejtori. Terreni është shumë i vështirë. Sidomos të punuarit me tre turne është e vështirë” (Pjesëmarresja 6).

- *“Ka kolege të mia që bëjnë deri në 15 roje në muaj, të kalosh 15 nete në spital është cmenduri, e tilla është puna e tilla është mungesa për mjekët anestezistë për fat të keq” (Pjesëmarresja 4).*
- *“Në fund të ditës, do më ngelet një punë e pambaruar, edhe pse mund të jeni oraret e tejzgjatura, p.sh., dita nis në 7 mëngjes edhe mund të mbyllet diku nga ora 12 të darkës apo pak më vonë. Nuk ka asnjë punë të pambaruar” (Pjesëmarresja 1).*

III.10. Shanset e pabarabarta për gruan.

Pabarazia rëndon shumë mbi gratë dhe kjo duket qartazi teksa në analizen e të dhënave cilësore spikasin pjesëmarreset në këto studime permendin refuzime, deklaratash të forta nga familjarët e tyre, dyshime për aftësitë e tyre nga ana e punëdhënësve. Edhe pse gratë të arritura në profesionin e tyre, atyre u është dashur të punojnë dy herë më shumë sesa një burrë për të arritur të njëjtën gjë, për faktin se në shoqërinë shqiptare, gruaja është parë gjithnjë në funksion të dikujt ose dikujt por jo në funksion të vetvetes.

- *“Ime motër është martuar para meje, shumë më e re. Është martuar rreth gjashtë apo shtatë vjet përpara meje, dhe kur u martua motra për herë të parë dëgjova shprehjen “Shkoi në bukë të vet”. Domethënë, në jemi ky brez që jemi edukuar me mendësinë që vajza është mysafire në shtëpinë e nënës dhe babait, dhe buka e saj është pikërisht bashkëshorti dhe buka mund të them se është diçka shumë shumë e rëndësishme. Domethënë, të të përmendet “shkoi në bukë të vetë” ... Dhe ti mendon se ajo është buka jote, dhe ai është gjithçka, ai është zoti yt, është pronari yt, domethënë, kur ka në 2010, 2011 që është martuar ime motër atëherë, në 2009 tamam tamam, të të dali termi “Shkoi në bukë të vetë”, mendoj se të tilla gjëra pastaj rrjedhin nga kjo sepse ai është gjithçka, ajo duhet të dëgjojë, burri është shtylla e shtëpisë, askush nuk duhet të kundërshtojë” (Pjesëmarresja 2).*
- *“Jam trishtuar shumë tani që provoj të shikoj punën e regjizoreve femra në Shqipëri. Flas gjatë komunizmit. U bë një film i tërë mbi regjizoret se mirënjohur në Shqipëri nga një regjizor mashkull sigurisht, dhe më erdhi rëndë nga vetja ndërsa shikoja filmin*

sepse ndoshta as shtatë minuta nga 60 minuta nuk iu dedikuan procesit të saj në punë, por të gjithë trumpetonin “Kineast, teknikien, fëmijë që punuan me regjizoren” se sa mama e mirë ajo ishte, se sa grua e dedikuar ishte” (Pjesemarresja 5).

- *“Ajo që më bëri përshtypje, salla e arkivit u mbush plot me familjarë, teknikien, brezi i vjetër, brez i ri, dhe prapë, edhe pse kjo ishte një ngjarje që e gatova unë, prapë njerëzit po flisnin se sa nënë e mrekullueshme ajo ishte. Edhe më irriton pak ky fakt sepse në njëfarë mënyre, ishte sikur të justifikojë faktin që “Okej okej, ajo ishte regjizore e mirë, por ajo nuk harroi asnjëherë të ishte dhe grua e mirë”. Një minutë. “Nuk më ka ndodhur ndonjëherë që ne të merremi me regjizorë të madh edhe të diskutojmë se sa baba i mirë ka qënë ai”. Ah sa burrë i mirë!” (Pjesemarresja 5).*
- *“Për mua ishte problematike që unë asnjëherë nuk gjeja veten. Jo se pretendoja të gjeja veten në të gjitha, por të paktën të shikoja një individ që merr vendime për veten. Edhe këtë unë pothuajse asnjëherë nuk e shoh në kinematografinë shqiptare. Femra është gjithmonë në funksion të dikujt. Në funksion të të dashurit, në funksion të prindit, në funksion të punës së saj, po asnjëherë ajo si një agjent më vete që bën që gjërat të ndodhin” (Pjesemarresja 5).*

III.11. Gruaja sipas perceptimeve të opinionit publik.

Nga analiza e të dhënave u identifikuan disa këndvështrime të rrethit shoqëror, familjar, faqefisnor, apo të kolektivit të punës rreth zhvillimit profesional të gruas. Ato nuk kanë refuzuar të ndajnë gjatë intervistave disa nga përjetimet e tyre me të forta, pa filtra në raport me opinionin publik që ekziston mbi figurën e tyre si profesioniste. Opinioni që në disa raste kanë zgjedhur të kundërshtojë fort me ze, ose në disa raste të tjera me punën e tyre në heshtje, duke sfiduar çdo këndvështrim seksist mbi to.

- *“Studimet që në ‘95-sën e deri tani, mua nuk më duket se jemi gjëkund. Nuk janë të krahasueshme. Nëse në vitet ‘90 në botë filloi të rishikohet roli i femrës në kinematografi, ne në Shqipëri ende nuk e dimë se ku jemi. Në 2013-ën kur filluam këtë restaurim, të gjithë na mendonin të çmendur. Unë nuk do ia uroja asnjëherë netët pa gjumë që kemi parë çdo punë të regjizores se njohur, duke filluar që nga periudha kur ishte montazhiere, kur ishte që merrej me dokumentare e derisa arriti që të merrej*

me filmat artistikë. Unë mund tju them këtë personalisht, që kur promovohet puna e regjizores se njohur shqiptare dhe puna e burrit të saj po ashtu regjizor, djali i tyre vazhdon e flet për të atin në vend që të flasë për të ëmën. Kështu që janë të pakrahasueshme. Fare! Pyetja që sa më bëtë. Sepse roli i kineastes femërore në Shqipëri ende nuk është parë, studiuar, dhe kuptuar. Ne na duken sikur janë aksidentale arritjet e regjizores se ndjere” (Pjesëmarresja 5).

- *“Edhe tashi kur vjen puna, ka shumë punime që duan inxhinier gjeoteknik në terren...Jo! Duan djemtë, sepse thonë “Ku e dini ju se si i bën vajza”. Domethënë, kanë një hezitim këto firmat private, ndoshta për drejtueset femra flas, se drejtuese në atë kohë, para '90-ës, s'kishte asnjë gjë private. Ishin të gjitha shtetërore dhe ishte e vendosur që X do shkojë në punë në kantier, do shkonte dhe pikë, mbaroi. S'pyeste njeri “A të pëlqen a s'të pëlqen?”. Pastaj, po të mos punonte merreshe me tjetër muhabet po...kurse tashti s'bëhet asnjë gjë po s'deshi sipërmarrësi. Po nuk deshi pronari i firmës...Aq më tepër që nuk...domethënë...ka dalë një çikë kjo tashti, këto vitet e fundit, kjo puna që “Hë më se është grua!”. Vitet e fundit. Nuk ka qënë më përpara. Tashti ndihet një çikë” (Pjesëmarresja 8).*
- *“Po ta shikosh ne nivel administrativ, e shikoj këte diskriminim. Qe do te thote ne nivel te te besuarit te drejtimit te lajmeve si linje editorial; ne nivel te drejtimit te televizionit, deri tani kemi vetem nje emer qe eshte gruaja me emrin X. Mungojne emrat e tjere drejtore te pergjithshem, ndersa gjithë te tjeret ne nivel ekzekutiv jane burrat. Kjo me bie ne sy, sepse edhe grate kane treguar me kembenguljen e tyre, me pune ndoshta me shume se sa burrat, kjo mund te jete qe eshte tipar pozitiv i grave, por per mua te te besuarit te administrimit te televizionit, aty dallohet” (Pjesëmarresja 3).*
- *“Por ka nje opinion ne Shqiperi, qe ato shohin nje doktor perball nje doktoreshe, kane me shume besim tek ai doktori. Por qe nuk me bezdis (nderhyn intervistuesja: “Pra, nuk eshte se e ke pasur ndonjehere problem kete gje?”). Ne zakonisht punojme ne ekip, une kam bere gjate roje me nje kolegun tim i cili ndodhet aktualisht ne Korce p.sh., fakti qe une edhe ai i thonim te njejten gje, atij i besonin me shume, nuk eshte se me prishte shume pune, por ok eshte mentaliteti (qesh) i shqiptareve” (Pjesëmarresja 4).*

- *“Me eshte thene qe ne fillim, qe si do punosh, je femer, oret e gjata, pse e zgjodhe kete lloj profesioni...dmth nuk eshte se mbarojme konsultat ne oren 12 ikim dhe vazhdojme. Dmth nese une jam ne salle, une ngel ne salle derisa ta nxjerre pacientin nga salla. Kemi nje shprehje ku ke vene duart ke vene koken. Dmth., ai eshte pacienti im dhe une pergjigjem per ate, edhe pas 2-3 ditesh qe ka qene ne salle. Kam pergjegjesine une qe e fus ne salle, te dali e me pas te vazhdoj. Ose nje paciente qe ti merr ne reanimacion dhe eshte kontakti i pare qe ti krijon me familjarin. Pavaresisht se ne reanimacion te gjithe bejme roje, e levizim me rradhe. Keshtu qe, paragjykimi ka qene ne fillimet e mia, pastaj kur ata shohin qe ti afirmohesh, ka femra qe punojne shume e me shume se meshkujt aty. Ka femra qe bejne shume e me shume roje se sa djemte” (Pjesemarresja 4).*
- *“Ai thoshte qe “ti nuk mundesh te punosh me keta femijë” dhe unë thoja me veten time qe “kush je ti qe ta përcaktosh a mundem unë apo s’mundem unë, ti qe nuk më njohe kurrë. Ti nuk i dhe shansin vetes qe të njohësh këtë punonjësen, këtë pretendenten, për tu marrë me këta femijë” (Pjesemarresja 2).*
- *“Kane qene keto pyetje: “Me sillni nje doktor te vjeter, mos hajde ti cupeline”. Ka patur gjera te tilla, por qe ata jane paciente, kane halle dhe ti do i mirekuptosh per ato qe kane” (Pjesemarresja 4).*
- *“Më rrihte zemra fort, më lindnin pikëpyetjet të tipit “a do tia dal?, a s’do tia dal?, a do më suportojnë?, a nuk do më suportojnë?”. Dhe kjo është situatë më vete, sepse kam patur fillimisht njerëz që nuk më njihnin, që kishin shumë pak besim tek potenciali, tek forca ime, ose tek dëshira, ose tek aftësitë, nuk e di sesi të ta cilësoj (Pjesemarresja 2).*
- *“Ndihet ne cdo moment, qe kur ti nuk del dot nga shtepia se nuk ke akses. Qe kur ti del nga shtepia dhe ndeshesh me paragjykimin “oh sa gjynah, i shkreti”, qe nga mungesa e sherbimeve, ose ka sherbime me para qe prinderit nuk i perballojne dot. Ne fakt, te jesh grua me aftesi te kufizuara, shume nga keto perfituese te tonat na thone qe ne jemi te dhunuara ne cdo moment. Jemi te dhunuara qe nga shtremberimi i fytyres se babait qe duhet te na shoqeroje per ne shkolle apo per nje takim dhe eshte lodhur se beri kete gje. Dmth., ne cdo moment jemi te gjykuara, jemi si barre qofte edhe per familjen” (Pjesemarresja 7).*

- *“Me ka ardhur keq tani qe po kujtohem, kur fotoja ime u be publike tek infektivi. Ajo ishte thjesht nje foto qe une e postova per veten time. Dhe kishte shume komente nga njerezit, te tipit qe c’eshte kjo qe punon, qe per mua m’u duke shume politike, per mua personalisht. Dmth., te gjithë benin shume te preokupuar ne ato mesazhet e fb, ministres me shume m’u duke sikur te tjeret donin te shanin, por nuk eshte se e vrava mendjen prape” (Pjesemarresja 4).*

III.12. Pasqyrimi i mendimeve per partneret e tyre.

Nga analiza e te dhenave cilesore jane zbuluar qendrimet personale te grave kundrejt bashkeshorteve te tyre dhe rolit qe ata kane luajtur ne familje. Grate priren te vleresojne ndihmesen e bashkeshortit por nga ana tjeter nuk e shikojne si conditio sin equa non per vete-realizimin e tyre.

- *“Ne mblidheshim ne darke ne shtepi. Edhe ai ka qene diku ne nje pozicion drejtues tere jeten, me shume pergjegjesi ne nje biznes qe shkonte ne oren 8 dhe kthehej ne 8-9 te darkes. Dhe ne kemi patur nje cep, nje kend ketu qe ka qene cepi i vajzes time te vogel qe vinte nga shkollat, e ushqenin gjysherit, edhe ulej aty dhe shikonte televizor. Para dy vitesh, kompania ku punonte im shoq u mbyll dhe ai filloi nje pune qe normal nuk ishte ne pozicionin qe e kishte pasur dhe kishte nje orar fiks vinte ne oren 5 ne shtepi. Mirepo na zinte cepin (qesh), zinte cepin dhe merrte telekomanden ne dore, nuk e kishte marre kurre, se s’kishte pasur kohe. Edhe problemet, edhe sot e kesaj dite ai cep eshte i zene nga im shoq qe tani punon online nga shtepia me kufje ne vesh, edhe eshte shume problem per time bije. Cepi nuk po lirohet!”(Pjesemarrja 7).*
- *“Unë ia kam dalë edhe kur kam patur partnerin dhe kur s’kam patur partner. Domethënë është uni që është më i rëndësishëm. Të kem një partner që të mbështet është një diçka plus, po prandaj themi që është gjithmonë e rëndësishme qënia. Çdo gjë tjetër është plus (Pjesemarresja 5).*

- *“Pamvarësisht se ai ishte në një punë me shërbime, Kështu që, domethënë...në njëfarë mase ishte si të thuash, si një mysafir në shtëpi. (qesh) Megjithatë... një dashuri të këtij lloji, domethënë kaq të madhe, e një mbështetje për çdo gjë, që ty të jepte kaq shumë energji pozitive që i kompensonte të tëra këto” (Pjesëmarresja 8).*
- *“Atëhere ka qënë në fillim fare, kur unë u prezantova me këtë jetën reale se çdo të thotë të jesh një nënë, një grua, një grua në shtëpi dhe grua në karrierë, ishte shumë e vështirë. Një trysni e jashtëzakonshme. Një mungesë suporti, mbështetjeje, të gjitha, të gjitha, të gjitha me radhë. Kisha menduar një realitet le të themi diçka ndryshe, dhe doli tejmasë ndryshe” (Pjesëmarresja 2).*

IV. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME.

Ne kete kapitull te fundit te raportit pasqyrohen gjithë konkluzionet dhe rekomandimet kryesore duke respektuar paanshmerine si dhe ne perputhje te plote me vlefshmerine e te dhenave te verteta te gjeneruara nga aktiviteti kerkimor. Studimi nxjerr ne pah se pavaresisht stigmave, grate qe jane arsimuar dhe kane punuar fort per t'u rritur profesionalisht dhe per te spikatur ne disiplinat respektive, kane fituar nje pozicion siperor ne karrieren e tyre, pa u viktimizuar megjithe disavantazhet e shumta qe i duhet te perballlet me mendesine e shoqerise ne te cilen bejne pjese. Keto gra kane gene aktive ne dhenien e ndihmes se tyre si profesioniste pas termetit shkaterrimtar te nje viti me pare dhe gjate pandemise, duke treguar dhe njehere kurajon qe i karakterizon per t'u perballur me ccdo sfide dhe pse jo per te ofruar dhe nje qasje tjeter me origjinale kundrejt pasojave qe sjellin fatkeqesite natyrore.

IV.1. Perfundimet.

1. Ekspertiza perzier me empatine qe i karakterizon grate i ka bere te ndodhen shpeshhere ne qender te zgjidhjes se problemeve qe krijoi termeti dhe pandemia.

- Termeti dhe pandemia i ka prekur emocionalisht grate si qenie njerezore ne rolin e nenes, vajzes, gruas dhe bashkeshortes, por kjo nuk i ka penguar te perkushtohen si profesioniste ndaj atyre qe kane me shume nevojë, jasht orbites familjare.

- Grate kane zgjedhur te jene ne frontin e krizes, megjithese per opinion publik ato duhet te ishin ne shtepi duke u kujdesur per familjen.
 - Grate nuk preferojne te perceptohen si qenie te dobeta veccanerisht kur perballen ne situata te veshtira sikurse termeti dhe pandemia.
- 2. Bashkeshortet/partneret jane te rendesishem per te mos cenuar/kompromentuar punen e gruas per te ndertuar karrieren e saj profesionale.**
- Grate i shikojne bashkeshortet si pjese e rendesishme te familjes se tyre, duke u dhene rolin qe u takon si kontributore ne perkujdesin ndaj femijeve dhe angazhimeve te tjera familjare.
 - Grate nuk mendojne se bashkeshorti/partneri eshte motivi i realizimeve te tyre vetjake, por jane te ndergjegjshme se pa mirekuptimin e tij nuk do t'ia dilnin te ruanin familjen dhe te cconin perpara pasionet e tyre.
 - Grate jane te gatshme te tregohen tolerante ne nje marredhenie me qellim qe kjo te sherbeje si burim frymezimi edhe per bashkeshortin/partnerin ne jeten e tyre familjare.
- 3. Pertej termetit dhe pandemise, grate ndihen te sfiduara ne perditshmerine e tyre nga perceptimi per moshen, nga pritshmerite qe kane te tjeret (kolege, bashkepunetore, vartes, drejtues) ndaj tyre nderkohe qe nuk u ofrohen shanse te barabarta per nje sasi dyfish pune qe u duhet te bejne.**
- Nese jane me te reja grate nenvleresohen per aftesite, ndersa nese jane me te rritura ne moshe, atehere ato dyshohen per energjine dhe fuqine qe kane per te ccuar perpara pune me orar te tejzgjatur. Mosha eshte nje spirance qe gruaja e mban me vete qe kur lind pasi eshte instrumenti me te cilin opinion publik i shoqerise shqiptare e perdor per ta “goditur” sipas rastit ate.

- Grate perpiqen te shmangin burokracine ne administraten publike pasi jane te prirura drejt rezultatit konkret me ritmin e duhur te efektivitetit.
- Per shkak se nuk i duan burokracite dhe jane strikte dhe korrekte ne ushtrimin e detyres, shpesh kjo i penalizon ne punesim, duke perfshire dhe sektorin privat. Kjo pasi gruas i mungon fleksibiliteti ndaj shkeljes ligjore dhe asaj ccka konsiderohet si informale.

4. Grate mbizoterojne aktualisht ne shumicen e sektoreve, dikur domein te burrave

- Eshte fakt qe grate ia kane dale te mbizoterojne ne inxhinieri, siperparrje, mjekesi, gazetari investigative te kronikes se zeze etj.
- Megjithese jane me shume se burrat ne fushat e siperpermendura nuk jane te vleresuara njesoj ne syte e punedhenesit, eprorit dhe opinionit publik.
- Shkak per kete jane steriotipet gjinore qe ngrene dyshime mbi aftesine e gruas, ose e kunderta te zbatuarit te detyres me “me shume rigorozitet se c’duhet”.

5. Prirja e gruas per t’u vetesakrifikuuar memesine

- Per t’u vete-realizuar si profesioniste, grave u eshte dashur te heqin dore nga realizimi i te qenurit nene, ose ne rastin me te mire duke reduktuar numrin e femijeve, ne vetem nje te tille.

IV.2. Rekomandimet.

- Grate duhet t’i kushtojne me shume vemendje vetvetes, sepse kjo ul nivelin e vete-viktimizimit

- Rekomandohet nderhyrja ne kodin e punes per te parashikuar mosabuzimin me orarin e punes tek grate nisur nga fakti qe ato kane shume role
- Te identifikohen rastet pozitive te bashkeshorteve bashkepunues per t'u shendrruar ne modele referuese neper trajnime me burrat mbi rolin qe duhet te luajne ne familje.
- Duhet te rritet prania mashkullore ne fushatat ndergjegjsuese per te drejtat e grave dhe kundra dhunes ndaj tyre ne te 12 muajt e vitit dhe jo vetem ne 16 ditet e aktivizmit, pasi kjo nuk mjafton per te sjelle ndryshimin e pritshem.
- Institucionet e administrates publike dhe kompanite private duhet te rishikojne politikat e tyre gjinore. Nevojitet nje qasje pro gras jo vetem ne numra te punesuarish, me fokus te veccante perfshirjen e tyre ne nivele drejtuese.

BIBLIOGRAFIA

Ajdini, J. (2011). *Problemet sociale*. Tiranë: Shtëpia Botuese Albpaper.

Goldstein, J. (2003). *Marrëdhëniet ndërkombëtare*. Tiranë: Shtëpia Botuese Dituria.

Miller (1965). *Feminist, gender and sexuality studies commons, social welfare commons and the social work commons*. Webstern Michigan University.

Tahiri&Rama&Sota (2013). *Metodat kerkimore ne shkencat sociale*. Tiranë: West Print.

RAPORT KËRKIMOR

FORCA ËSHTË GRUA



VIGÀN
State of giants.